



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS - SHTIME
Nr.01-060/01-15630/22 datë:20.06.2022



Npi – 01/192 datë: 30.06.2022

Duke u bazuar në nenin 43 dhe 49 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, si dhe në bazë të nenit 3.13 të Rregullores së Punës së Kuvendit dhe Komiteteve, Npi – 01/114 të datës: 26.04.2019, përmبiedhjen e Kuvendit të Komunës, të mbajtur më: 30.06.2022 është nxjerrë ky:

E K S T R A K T
P R O C E S V E R B A L

I MBLEDHJES SË -VI- TË RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË SHTIMES
E mbajtur më: 30.06.2022, (e enje) në ora 9.⁰⁰ h. në sallën e Kuvendit.

Në mbledhje kanë marrë pjesë, Kryesuesi i Kuvendit: z.Adnan Ademi, Anëtarët e Kuvendit: Rrahman Jakupi, Perparim Ramusa, Lumni Amrushi, Besartë Musliu-Spahija, Adem Ramadani, Hasan Avdyli, Hamëz Tërshani, Albana Podvorica, Adelina Beqaj, Besnik Seferi, Gëzim Haxhiu, Reshat Mujota, Aslian Beqaj, Shkurte Mustafa, Sanije Sadiki, (Heroina Selmani on-line), Rrezartë Ramadani, Muhamet Ademaj dhe Rexhep Gashi.

Në mbledhje përvèç anëtarëve të Kuverndit kanë marrë pjesë edhe: Kryetari, z.Qemajl Aliu, Drejtoret, Nga ZKF-ja z.Bujar Ferati; Nga Zyra Ligjore z.Lulzim Muharremi; Nga zyra për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore, z.Reshat Gashi; Nga Zyra për Informim, z.Gazmend Ademaj, Shpëtim Gashi dhe Miftar Miftari; Nga Radio Zëri i Shtimes, z.Muhamet Hoxha; Nga OJQ "YAHIR" z.Ferdian Shala; Dhe znj.Valmira Hoxha, praktikante; Si dhe Gani Ademaj, qytetarë i interesuar.

Mbledhjen e hapi Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi, i cili pasi përrshëndeti të gjithë të pranishmit Konstatoj, Kuorumin e mjafsheshëm përmbytjen e mbledhjes së Kuvendit. Përmbytja kemi propozuar këtë:

R E N D D I T E

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit më 31.05.2022,
2. Pyetje Përgjigje,,
3. Korniza Afatmesme Buxhetore 2023-2025 (Pas diskutimit Publik),
4. Propozim -Vendim përmbytjen e dy anëtarëve të Komisionin përmbytjen e Bursave përmbytjen e Studentëve,
5. Propozim – vendim përmbytjen e Komisionit përmbytjen e përgjedhjen e drejtoreve të shkollave,
6. Propozim-Vendim përmbytjen e lokacionit përmbytjen e Çerdhe në fshatin Petrovë,
7. Formimi i Komisionit përmbytjen e Vizita në Teren lidhur me Monitorimin e Implementimit të Investimeve Kapitale (mund të bëhet në bashkëpunim me shoqërinë civile)
8. Informatë nga drejtoria përmbytjen e Inovacion.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Para se të hapi diskutimin përmbytjen e ditës, po sqaroj se sot në këtë sancë e kemi të kyqur on-line anëtarët e Kuvendit znj.Heroina Selmani e cila gjindet jashtë Kosovës,

kështu që diskutimin dhe votimin e sajë mund ta përcjellim përmes video-linkut që po transmetohet me video-projektor, në vazhdim hapi diskutimin për rendin e ditës.

z.Përparim Ramusa; Përshëndetje, te pikat e rendit të ditës, ne si PDK propozojmë që pika e 8 të hijet nga rendit të ditës. Arsyetimi është se Kryetari i Komunës ka blerë votë në Kuvend, dhe e ka bërë drejtoreshën në këtë drejtori, dmth. arsyja eshte se ka konflikt interesit.

z.Rahman Jakupi; Përshëndetje, meqenëse një anëtar i Kuvendit është i kyqur on-line, a mund të na sqaroni se cila pikë e LVL-së e precizon kyqjen on-line në mbledhjen e Kuvendit.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Qartazi është e precizuar me nenin 3.6 në Rregulloren e punës të cilën ju e keni aprovuar.

z.Besnik Seferi; Përshëndetje, sa i përket propozimit të PDK-së për largimin e pikës së 8, unë mendoj se nuk është dashtë ta japid një propozim të tillë sepse nëse po thojnë që ka konflikt interesit, atëherë pikërisht për këtë arsy duhet të ipet raport nga drejtoresha, ndërsa Muhameti mundet me dalë nga seanca, por jo të hijet si pikë nga rendi i ditës.

z.Reshat Mujota; Përshëndetje, edhe unë jam kundër për me u hjekë kjo pikë. Nuk desha me folë por Besniku më shtyri. Me kérkesën e Kryetarit janë hapë dy drejtori, drejtoria për Inovacion dhe drejtoria për Prokurim Publik. Drejtoria për Inovacion nuk ka buxhet si dhe ka konflikt interesit. Unë kam kërkuar që kjo drejtori me u hjekë, kur thuhet se është formuar më herët për me i rahatuar militantët, pse atëherë po e bëni përsëri.

z.Besnik Seferi; Replikë me z.Reshat Mujotën, e para është shumë mirë që LVV-ja nuk i ka formuar këto drejtori por i ka xhetë si të tilla, dhe buxheti për to ka ekzistuar edhe më parë dhe ekziston, ata zyrtarë që janë aty kan me u paguar diqysh. Sido që të jetë qite në votim dhe shumica vendosë.

z.Reshat Mujota; Replikë, Besnik deklarohu se cilen parim je duke e mbajtur a parimin e LVV-së apo parimin e tënd personal? Unë e kam përkrahur LVV-në për mos me u formu kjo drejtori.

z.Besnik Seferi; Replikë, unë jam tu folë këtu sipas parimeve të mia, dhe flas në emrin tim personal. Unë i mbrojë parimet e LVV-së.

Kryetari, z.Qemajl Aliu; Përshëndetje për të gjithë, meqenëse u hapën shumë temë rrëth drejtorive dhe u hodhën disa akuza, unë dua ta sqaroj këtë çështje për qytetyarët e komuns së Shtimes. E vërteta është se ne kemi koalicion me LDK-AKR, kështu që unë nuk i përcaktoj propozimet e tyre. Sa i përket buxhetit për drejtori, ne e kemi marrë qeverisjen pas miratimit të buxhetit për këtë vit 2022. Dhe tanë ne nuk mund ti ndryshojmë drejtoritë, kte pra e dini shumë mirë ju që po mundoheni me futë konfuzion. Edhe një herë, ne kemi qenë dhe jemi të detyruar të punojmë me këto drejtori ekzistuese që ju vetë i keni krijuar dhe e keni miratuar buxhetin për to. Kur të vie koha që ta aprovojmë buxhetin për vitin 2023 ne do të rishikojmë edhe numrin e drejtorive. (Ju kujtohet maksima tashmë e njohur "Lirinë nuk ua solla unë por e gjeta në mesin tuaj").

z.Rexhep Gashi; Përshëndetje, vërtetë është për me u quditë se si ata që e kanë formuar këtë drejtori ta shjanë kundër. Nëse nuk ka buxhet për këtë drejtori atëherë është dashur që moti të rishikohet. Meqenëse drejtoresha nuk është në mbledhje unë propozoj që kjo pikë të shtyhet, ndërsa nëse vjen deri në fundë të mbledhjes atëherë le të na jep informatën. Unë mendoj se edhe ata që e kanë formuar atëherë këtë drejtori e kanë pas një interes.

z.Përparim Ramusa; Du me nisë me fjalën që e tha Kryetari, "Lirinë nuk ua solla unë por e gjeta këtu" unë nuk thash për me e hjekë drejtorinë, por për me hjekë Informatën, sepse është konflikt interesit.

znj.Adelina Beqaj; Përshëndetje, Kryetari sa herë po folë po e demanton veten, kjo është seanca e 6 dhe vetëm po e demanton vetveten.

z.Reshat Mujota; Nuk ka nevojë me na i treguar historinë e Skënderbeut. Kryetar ata që e kanë votuar e kanë emrin dhe mbiemrin, se kush e ka votuar e kush jo. Jam krenar që jam zgjedhë në mandatin e dytë me votën e qytetarit, dhe jau kamë mundur të gjithë drejtorat.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Konstatoi, Kuorumin prej 20 anëtarëve të Kuvendit prezent në mbledhje.

* **Kuvendi i Komunës, me 10 vota "Për" me 10 vota "Kundër" dhe me 0 vota "Abstenim",** (Kryesuesi i Kuvendit ka përdorur të drejtën e tijë për votën e dyfisht "Për" sipas nenit 48.1 të Ligji për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040) kështu që me 11 vota "Për" aprovoi rendin e ditës.

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit më 31.05.2022

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Rrahman Jakupi; Procesverbali ka 105 gabime gjuhësore, ne nuk do ta votojmë këtë procesverbal sepse del në ueb-faqen e komunës.

znj.Adelina Beqaj; Përveç gabimeve drejtshkrimore që u cekën, edhe diskutimi im komplet është ndryshuar.

z.Besnik Seferi; Nëse ka gabime ato duhet të përmirësohen.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Konstattoi, Kuorumin prej 19 anëtarëve të Kuvendit prezent në mbledhje.

* **Kuvendi i Komunës, me 10 vota “Për” me 8 vota “Kundër” dhe me 1 votë “Abstenim” aprovoi ekstrakt procesverbalin nga mbledhja e Kuvendit më 31.05.2022.**

Pika 2

Pyetje Përgjigje

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Reshat Mujota: Po e kërkoj njirkoj një sqarim nga Kryetari, që ka nënshkruar një marrëveshje për komunën e Shtimes, e që ka të bëj me kanalet e tokave bujqësore, unë e përgëzoi Kryetarin për këtë marrëveshje, por që zyra për informim e ka publikuar informacionin jo të qartë lidhur me këtë, duke shkruar se Marrveshja kap shumën rrith 350.000 euro për ndërtimin e sistemit (kanalit) të ujitjes, ndërsa në marrëveshje shkruan për kanalet kulluese, dhe si mund të betonizohen kanalet bujqësore kjo e para dhe e dyta a do të përfshihen fshatrat e rrafshit siq janë Rashinca, Muzeqina etj. Pyetja për Kryetarin është kjo, sipas kësaj marrëveshje të nënshkruar a janë ato kanale kulluese apo janë kanale për ujitje?

znj.Adelina Beqaj; Kjo nuk është pyetje por është një çështje, është turp për Kryetarin, pse nuk e përkujtoni datën e vdekjes të doktorit nga Reçaku Dr.Vezir Bajrami.

z.Muhamed Ademaj; Pyetja ime ka të bëj me largimin e të rinjëve nga Kosova, a ka ndonjë informatë se sa është numri i pleqëve në komunën tonë që janë pa përkujdesje?

znj.Albana Podvorica; Përshëndetje, Unë e lexova informatën e drejtorisë për Inovacion ku thot se e kemi hartuar planin vjetor të punës, pyetja ime është se a e keni publikuar planin e punës dhe kur? Dhe pyetja e dyte për këtë drejtori që ka të bëj me bashkëpunimin me organizatat, në informatë askund nuk është përmendur, aktivitetet e rinisë që janë zhvilluar, pse nuk janë përmendur ato?

z.Hamëz Tërshani; Përshëndetje, meqenëse kemi të bëjmë me një problem aktual të mungesës së shpeshtë të ujit për pije, drejtori nuk qenka prezent por dua ta parashtoj si kërkesë për një informatë për gjendjen e furnizimit me ujë.

z.Rexhep Gashi; Është dëmtuar një kënd për lojnat e fëmijëve, far masa keni marrë për me i ruajtë këto lojna për fëmijë? Dhe pyetja e dyte pse nuk po zbrazen shportat e mbeturinave? Pyetja tjetër të cilën e kam bërë disa herë e që nuk kamë marrë një përgjigje të mirëfillt është se te sheshi i dëshmorëve është heqë një skulpturë e përpunuar nga metali, ku gjindet ajo skulpturë tanë, dhë a e keni shikuar se në far gjendje është ajo?

z.Hamëz Tërshani; Rexhë, minimalisht dy herë ke marrë informacion për atë skulpturë, kur ioshë unë drejtori.

z.Rexhep Gashi; Nëse e din ti se ku është, tregona pra edhe neve publikisht, po ashtu tregona se në far gjendje është:

z.Reshat Mujota; Më erdhën dy pyetje nga qytetarë të cilët jetojnë jashtë Kosovës, dhe po presin një përgjigje. Pyetja ka të bëj me kryerjen e obligimeve tatimore. Pyetja është për Kryetarin se a ka mundësi për me u shty afati 6 mujor i pagesës të tatimit në pronë për kësttin e 6 mujorit të parë, për mos me u përfshi në pagesën e dënimit për mospages?

zpj. Besartë Musliu-Spahija; Përshëndetje, unë kam një pyetje për DSHP-në, a ka mundësi për me qit një shirit në rrugën për në Carralevë për mos me i hedhë imbeturinat? Pyetja e dytë është se kurë do të bëhet aktivizimi i Çerdhes për fëmijë “Albiona Asllani” në Shtime?

Z. Lumni Amrushi: Nesër është 1 Korriku, a do të fillojnë punimet për dy projektet e parapara në fshatin Pjetërshticë, asfalltimi i rrugës "Idriz Ajeti" dhe projektin tjetër asfalltimi i rrugëve brenda fshatit, sepse gjatë diskutimit publik qytetarët i kanë përmendur ato? Pyetja është për DPUKGJ-në.

z.Rahman Jakupi; Dje është mbajtur mbledhja e KKSBB-së, pyetja është a ka pasur ndonjë temë të veqantë që është cënuar siguria në komunën e Shtimers?

z. Besnik Seferi; Shkurt po i bie, edhe unë kam shumë pikëpyetje për sa i përket tatimit në pronë. Mendoj se është vendim i ngutshëm ky për pagesën e gjobës nëse vonohet pagesa e këstir të parë të vtitit. Meqenëse u tha se kemi fituar një donacion prej 40.000 eurosh, pyetja për DKA-në është a ka ndonjë plan ose ndonjë donacion tjeter për shkollat tjera? Tjetër është kërkesë e KPK-së ku edhe e kemi përmend në rekondit Npi-01/179 dt. 23.06.2022, për Kryetarin që drejtoret tē marrin pjesë në mbledhjet e Komiteteve. Pastaj nga zyra për informim është publikuar se është mbajtur mbledhja e KPK-së por jo edhe me u përcjellë me ndonjë fotografi.

z. Gëzim Haxhiu; Përshëndetje, unë i kam dy kërkesa për DKA-në, e para ka të bëjë me shkollën fillore “Lasgush Poradeci” paralelja në Rashincë, aty ka nevojë për furnizimin e shkollës me banka të reja, me ndërrimin e dyerve, furnizimin e shkollës me paisje teknologjike, siç janë fotokopje, kamera sigurie etj. Kërkesa e dytë ka të bëj me shkollën fillore “Emin Duraku” paralelja n paralelja në Davidovc, ku te kjo shkollë nevoitet rregullimi i banjove, fotokopje, por me rëndësi është rregullimi i rrëthojes të fushës së sportit, etj.

znej Adelina Beqaj; Në mbledhjet e kaluara e kemi ngritur si çështje, transmetimin e mbledhjeve në TV nga TV-Spin, ne kërkojmë që të ndërrmerrni ndonjë hap për këtë.

z.Përparim Ramusa; Edhe unë i përkrahu kërkesat e zoteri Haxhiut.

znj. Rrezartë Ramadani; Përshendetje, edhe unë e përkrahu kërkesën e Besnikut që drejtorat me marrë pjesë nëpër mbledhjet e Komiteteve.

z.Kastriot Shabani, drejtor i DZHE; Pershendetje, faleminderit për pyetjet. Fillimisht e kemi pas një thirrje nga Ministria e Bujqësisë për të konkuruar në këtë projekt, ne kemi shkuar dhe kemi konkuruar me një projekt për fshatrat Vojnovc, Davidovc dhe Godanc, dhe projektin ynë është pranuar.

z.Reshat Mujota: A ka mundësi që projekti me u shtri edhe në fshatin Rashincë, sepse këtë fshat e merr uji shpesh herë, Davidovcin nuk e merr uji, sepse e njoh pozitën e tyre shumë mirë. Shuma e projektit mu duk e mirë prandaj po pyes se a mund të përfshihet edhe fshati Rashincë.

z.Bujar Ferati, zyrtar kryesor financiar; Sa i përket Tatimit në Pronë, meqenëse kam qenë pjesë e stafit aty 6 vite po jap një sqarim, se ka ndryshuar ligji i Tatimit në Pronë, sepse ka qenë i paraparë që pagesa e këstit të parë duhej të paguhej deri më 30 Prill, mirëpo është bërë kërkesa dhe është vërejtur se ka nevoj për ndryshim dhe është zgjatur afati për pagesën e këstit të parë deri më 30 Qershor. Tani ne po dëshirojmë që me i ndryshu edhe datat por edhe pagesën e këmatave, dhe unë besoj se edhe kjo

z.Reshat Mujota; Çit 10% që e ka çitë kjo, është gjobë, kjo duhet me u hjekë. Unë për veten time e paguaj me irregull dhe nuk më rrok kjo gjobë por po flas për ata që nuk janë këtu dhe nuk mund ta paguaj, nuk ka bëj, nuk mund të jenë këtu.

z.Bujar Ferati, zyrtar kryesor financiar; Edhe një herë po e sqaroj, të gjitha shqetësimet jemi duke i adresuar. Qështja e Tatimit në Pronë është duke u riformatizuar komplet, edhe ne po presim që kamata e ndëshkimit me u hjekë. Ne do ti drejtohami deparatamentit me një shkresë të cilën do ta bëjmë publike.

Kryetari, z.Qemajl Aliu; E falënderoj qytetarin për pyetjen e paraqitur përmes delegatit z.Reshat Mujota, po ashtu i falënderoj të gjithë qytetarët që po i përgjigjen pagesave të tatimit në pronë. Duhet ta dijmë se Strategjia e grumbullimit të tatimit në pronë është strategji nationale, që hartohet nga ATK-ja. Më vjen keq për mërgimtarët për shqetësimet e tyre me vend, realisht edhe unë i kam gjysmën e familjes jashtë Kosovës. Ate qka mundemi ne me e bërë është që ta qojmë si sygjerim në ATK-ë nga

Komuna jonë. Sa i përket pyetjes së z.Hamëz Tërshana për furnizimin me ujë, është e vëprtetë se jemi duke pas pengesa për furnizim të rregullt dhe të mjaftueshëm me ujë, ne kemi diskutuar me zyrtarët e KRU "Prishtina" dhe kemi ardhur në përfundim se ka munges të kapaciteteve për rezerva të ujit, dhe tjetra është se këtë vit nuk kemi pas mjaftueshëm të reshura. Ne kemi pas takime me drejtuesit e Komapanis Rajonale të Ujit "Prishtina" në Prishtinë dhe na kanë njoftuar se janë duke punuar shumë me Organizatën "Katar" për sigurimin e ujit të pjes, dhe po bëhet fjalë për një projekt rrith 320.000 euro. Sipas këtijë projekti për një periudhë dhjetë vjeqare do të kemi rezerva të mjaftueshme të ujit. Ne po shpresojmë që vera e vitit tjetër me na gjetë me ujë të bollshem.

Lidhur me pyetjen për kolegut tim të profesionit, Dr.Vezir Bajramin, ne me familjen e tijë jemi miq shumë të respektueshëm këtë e dinë ata dhe të tjerët shumë mirë. Me fjalët e tua të tilla tendencioze, fyhet figura dhe personaliteti i Dr.Vezir Bajramit, por edhe e imja e edhe e jotja. Sa i përket donacionit në arsim, aty po bëhet fjalë për një donacion prej 120 mijë euro për furnizim me paisje për mirëmbajtje e që i kemi ndarë për tri shkollat më të mëdha të komunës tonë, për shkollën e mesme Gjimnazi, shkolla Profesionale dhe për shkollën fillore "Emin Duraku" nalt. Paisjet kryesish janë për mirëmbajtjen e higjenës ku jemi të bindur se do ta lehtësojnë shumë punën për stafin teknik, dhe do ta rrisim nivelin e higjenës në këto shkolla.

z.Lulzim Sahiti, drejtor i DKA; Përvendetje, lidhur me donacionin për tri pako në sektorin e Arsimit e spjegoi Kryetari, mirëpo unë desha të përgjigjem në pyetjen e anëtarit të Kuvendit z.Gëzim Haxhiu se kërkesa e tijë është plotësisht me vend, ne jemi duke bërë analizën e xhendjes dhe do të ndërrmarrim veprime konkrete për këtë.

z.Lumni Amrushi; Kërkoi nga ti si Kryesues që ta udhëheqni mbledhjen sepse ty të kemi zgjedhur Kryesues.

znj.Adelina Beqaj; Unë si Qemajl Aliu nuk të njoh, nuk ti di lidhjet familjare, në librin e shëndetësisë nuk është përkujtuar. Unë e përdori këtë gjuhë sepse ti e përdor këtë gjuhë.

Pika 3

Korniza Afatmesme Buxhetore 2023-2025 (Pas diskutimit Publik)

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Para se të hapi diskutimin për këtë pikë, lexoi rekomandimin e KPF-së, dhe të KPK-së, ky pra është një draft dhe kur miratohet buxheti merr formën finale për zbatim. I kemi pa gabimet dhe ato janë përmirësuar, dhe në vazhdim fjalën po ja jap Bujar Feratit për prezantimin e kësaj pike.

z.Bujar Ferati, zyrtar kryesor financiar; Përvendetje, si edhe vitet e kaluara edhe këtë vit duhet ta miratojmë KAB-in 2023-2025. Ky është një dokument i rëndësishëm për Komunën tonë. Bazuar në vendimin e Kuvendit për ta nxjerrë në diskutim publik, ne i kemi organizuar disa debate publike me qytetarë dhe me grupet e interesit. Dhe në fund kemi ardhur te një dokument final, të cilin ju e keni marrë me kohë. Propozimet që janë dhënë shumicën e tyre i kemi integruar në draftin e KAB-it. Në vazhdim ky spjegoi datat dhe vendet se ku janë mbajtur debatet publike. Kemi bërë një gabim teknik për sa i përket projektit rregullimit të rrugës Godanc i epërm-Zborc, e kemi shkruar gabimisht Zborc-Pjertërshticë, dhe këtë gabim e kemi përmirësuar. Ne e kemi kryer obligimin tonë për sa i përket debatit publik edhe pse pjesëmarrja nuk ka qenë në nivelin e dëshiruar. Nëse ka ndonjë pyetje jam gati të përgjigjem, përndryshe ju ftoj që ta miratoni.

znj.Adelina Beqaj; Ju faleminderit, unë e di që ky dokument është draft, por e di që është një pasqyrë. Godanci ka investime rrith 400.000€ ndërsa Petrova rrith.....? Një urë që unë e kam kërkuar për Petrovë nuk e pashë në KAB. Te zhvillimi ekonomik, në Rashincë dy projekte rrith 500.000€ në të njëjtën kolonë. Në Belinc 15.000€, ku është nënkalimi, pse nuk ka nënkalim në fshatin Davidovc. Ju në këtë KAB jeni të dështuar.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Projektet e reja, janë pa kod, ndërsa ato me Kod janë projekte në vazhdimësi.

z.Reshat Mujota; Faleminderit, u bë një punë e mirë në KAB, mirëpo unë kam disa vërejtje, e kam pa KAB-in edhe para debatit edhe tani pas debatit publik. Kamë vërejtë se KAB-i pas debatit publik ka disa zvoglime si psh. Projekti nr.8 rruga për Mollopolc 20 mijë euro për 2023, nuk mund të bëjmë asgjë duke marrë parasysh këto qmime. Pastaj prap te kolona 8, trotuar i rruga "Zona e Nerodimes" duhet të specifikohet nëse ka trotuar dhe ndriçim. Te zhvillimi ekonomik, rregullimi i rrugëve në Mollopolc cilat rrugë janë të përfshira në Mollopolc? Te shtabi i UÇK-së në Rancë, e kemi pas dhe prap e kemi vlerën prej 5000€, meqenëse janë pak unë propozoj që kjo shumë të rritet në 15.000€. Po ashtu propozoj që objekti te shkolla fillore në Mollopolc të renovohet, nuk e di se a e kanë në plan arsimi renovimin e sajë apo jo. Kabinetet nuk po shoh përviq sallave sportive, unë propozoj që le të bëhen më shumë Kabinetet nëpër shkolla.

z.Përparim Ramusa; 85 projekte i kemi votuar për me u realizu. Rruga për Zborc- Pjetërshticë është shty. Rruga Zborc-Godanc për vitin e ardhshëm nuk kemi nda asnjë cent. 85 mijë euro i keni të gatshme për QKM-ë pse nuk po filloni me punën. Në KAB i ka planifikuar 43 vetura për me i ble. Sallën e sportit në fshatin Zborc e keni hjekë.

z.Muhamed Ademaj; Faleminderit për prezantimin, kjo pra është një draft, apo kornizë orientuese, e cila ka qenë në diskutim publik. Jemi të kënaqur që ka rritje buxhetore. Ne në emër të grupit parlamentar të LDK-AKR e mbështesim dhe do ta votojmë.

z.Adem Ramadani; Unë kam një pyetje, asfalltimi i rrugës "15 Janari" dhe rruga "Pavarësia" thuhet se është shtruar me asfallt një pjesë dhe një pjesë me kubza, për cilën rrugë është fjala?

z.Rexhep Gashi; Projektet duhet të përkrahen pa marrë parasysh nghjyrimet politike. Unë kamë kërkuar një nën ose mbi kalim te rruga "Isak Brahimë" te lagja e Sahitovite në fshatin Pjetërshticë, sepse aty pra ka shkollë dhe irreziku është i madh. Po ashtu irreziku i madh është edhe te rruga "Ibrahim Rugova" në drejtim të fshatit Muzeqinë. Po ashtu unë po kërkoj që të ruhet një Krua me ujë te Mrizi.

z.Besnik Seferi; Faleminderit për prezantimin, që e ka bërë një punë të mirë për sa i përket diskutimeve publike. Kërkoj një sçarim për sa i përket planifikimit të shumave të projekteve, që ta dimë se ku kanë me shku dhe për çka kanë me u harxhuan mjetet buxhetore. Konkretisht dua ta di pëpr planifikimin e dy urave në fshatin Reçak dhe Muzeqinë, vlera e të cilave është 120.000€. Pastaj te qeshmja te lagja Tershani në Petrovë nuk e di se sa mjete janë planifikuar. Te rruga "Qamëria" ka një kundërmim të rëndë, ky projekt duhet të kalojë kah kjo rrugë dhe të mos anashkalohet, unë dua ta di se deri ku është planifikuar të shkojë projekti, a është përfshi e gjithë rruga "Anton Çeta" apo do të lihet në gjysëm sikurse pushteti i kaluar. Kemi pas rastin që pushteti i kaluar i qonte projektet në fshatrat pa banorë fare sikurse janë fshatrat Topillë, Llanisht, etj.

znj.Albana Podvorica; Unë propozoj që të asfalltohet dhe të bëhet ndriqimi i rrugës nga Kompleksi i masakrës së Reqakut e deri te Kulla e Lirisë.

znj.Adelina Beqaj; Demokrat Mujota ka kërkuar rregullimin e shtegut në fshatin Mollopolc. Llanishti është në komunën e Shtimes e jo në Ferizaj.

z.Besnik Seferi; Nuk jam kundra projekteve, por duhet me ju dhënë përparësi aty ku ka nevojë më shumë. Unë thash që ky pushtet të mos vazhdojë me projekte të tillë të pa rëndësishme.

z.Lumni Amirushi; Të gjitha projektet janë brenda komunës së Shtimes. Pse nuk po e bëni realizimin. Nuk ke mujt me investu diqka tjetër, si donacion nga Ministria. Mos të flasim për projektet në vazhdësimi sepse ato kanë kode. Nuk ka nisë me juve gjithçka. Kurgja nuk ka filluar.

Kryetari, z.Qemajl Aliu; Faleminderit për diskutimet, mirëpo sikur është një terndencë për spekulime që ju i bëni ZKF-së. Shumica e këtyre që u thanë këtu ishin politika të qeverisjes së juaj. Unë jam kryetar i Komunës së Shtimes dhe jo i ndonjë fshati, sikur po i duket dikuj. ZKF-ja e sqaroi së pse janë ndarë 240 mijë euro për vertura, por edhe mund ta sqarojë prap sa herë që e kërkoni, por nuk është nevoja me spekuluar.

z.Bujar Ferati, zyrtar kryesor finansiar; Për sa i përket pjesës politike, nuk po mundem me mbajtë evidencë; më falni se diskutimi më i madh këtu ishte politik, ndërsa ne këtu jemi profesionist, dhe nëse kërkohet ndonjë informacion konkret ne mund të përgjigjemi me shifra.

z.Rahman Jakupi; Ky është buxhet i shokëve dhe jaranave, ne juve Bujar Ferati, ZKF-ë ju besojmë, por këtyre ne nuk u besojmë, sepse thirren në emër të qytetarit, e aspak nuk punojnë për qytetarin. Prandaj ky pra është buxhet politik. Këtu nuk janë të përfshira Petrova e Muzeqina. Ne kur kemi qenë në pushtet kemi investuar edhe në fshatrat ku nuk ka pas banorë. Ky buxhet është vetëm i maskuar, sepse është kopje e buxhetit të kaluar. Këtë duhet ta rishikoni tërsisht, sepse kështu në këtë formë ne nuk e përkrahim. KKSB-ja ka qenë traditë për me u planifikuar, e që po shihet se plani i KKSB-së nuk është i përfshirë fare këtu.

z.Reshat Mujota; Ju lus që të bëhem konkret, pse gjuheni të gjithë përnjëher këtu, kur kemi pas shumë mundësi për me diskutuar gjatë procesit të debatit publik. Kaloja fjalën ZKF-së le ta sqaron, kur nuk e din se çka është KAB-i. Këtu nuk jemi tu aprovu buxhet. Jashtë Kuvendit bëni politikë sa të doni. Hajde të flasim konkretisht e jo në ajr. Kryesues jepjav fjalën për KAB-in te lutem.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Unë siç po e shihni jamë duke ua dhënë fjalën secilit asambleist, ju lus që diskutimet e juaja të sillen rrëth temës së KAB-it. Por mendoj se për sqarime shtesë fjalën duhet të ja japi ZKF-së.

z.Përparim Ramusa; Kryetari na e ka sjellë në Kuvend një KAB, në të cilin ka vendosë që rruga Pjetërshticë-Zborc të realizohet në vitin 2023, rrugë e cila duhet të kryhet në vitin 2022.

z.Bujar Ferati, zyrtar kryesor financiar; Kjo ka me kalu në sistem, nuk ka projekte në Godanc që kanë vlerën e 400 mijë eurove. Këtë draft dokument të KAB-it e kam hartuar unë me stafin në bashkëpunim me drejtoritë e komunës, dhe prap po du me sqaruar se kjo prap ka me u kthyer edhe një herë. Ky dokument i KAB-it duhet me u votuar sepse në te nuk janë vlerat që këtu po spekulohet. Kanë me u harmonizuar të gjitha projektet dhe kanë me u përfshi të gjitha fshatrat. Kemi edhe projekte konkrete për fshatin Reçak, mendoj se është mirë që ta shohim qytetarët dokumentin e KAB-it. Por unë e ndërtoj vetëm pjesën e numrave e jo edhe pjesën politike. E përmenda se ky dokument ka me kalu nëpër shumë etapa, ndërsa në muajin Shtator do ta shohim definitivisht pasqyrën e saktë të projekteve që do të investohen me rastin e miratimit të Buxhetit. Sa i përket veturave, ato janë vetëm projeksione që mundon me u ndryshuar, edhe Kryetari, te ky projekcion ka qenë i hamendshëm dhe ka pyetur se pse është ky projekcion për vetura, por unë e kam propozuar dhe kjo do ta shihni se mund të ndryshojë. Unë ju kisha propozuar që ta lexoni mirë dokumentin e KAB-it si pozita ashtu edhe opozita. Një urë që u përmend është e mundshme të mos jetë e specifikuar për arsy se aty nuk ka pas emërtim rruga, por do të rregullohet. Sa u përket projekteve të nën ose mbi kalimeve, te kto duhet me shiku fillimisht se a është obligim i Komunës apo i Ministrisë për ndërtimin e tyre në rrugët e caktuara, të definohet qartë dhe pastaj të parashihet si projekt i Komunës. Shtabi i UÇK-së në Rancë, ky na ka shku keq si projekt sepse ka ardhë me vonesë, mirëpo kjo ka me u irregullu mirë nëse do të investohen aty 50 mijë euro ashtu qysh po planifikojmë. Sa i përket Kabineteve nëpër shkolla, mund të them se shkollat kanë me pas mjete të konsiderueshme për me u paisë me mjete të konkretizimit. Nëse pyetja është për objekte atëherë ajo është krejt diqka tjetër që duhet ta planifikojë drejtoria.

z.Reshat Mujota; Mendoj se ka mundesi me u ba ndonje objekt në oborr të shkollës pa kabinet; e kam fjalën edhe përojektet e pa përdorshme. Unë pres një përgjigje nga drejtoria.

z.Valon Januzi, drektor i Administratës; Përshëndetje, sa i përket veturave, e i kemi 7 vetura në dispozicion, dy vetura i kemi me qira që i ndajmë€ për qira, dhe ne i kemi kalkuluar që me 41 mijë euro brenda pësë viteve, ato mbisin pronë e Komunës. Për këtë arsy kamë dhënë këto propozime për vetura 80 mijë euro e jo 200 mijë euro, siç po thuhet.

z.Grejtalb Emini, drektor i DPUKGJ; Përshëndetje, te pyetja e Ademit rruga "Pavarësia" është e ndarë në dy pjesë. Është ndërtuar ura dhe muri mbrojtës, ku është e planifikuar të asfalltohet edhe pjesa që e lidhë pjesën e rrugës së asfaltuar me pjesën e rrugës me kubza. Sa i përket Godancit që po përmendet disa herë, duhet një gjë ta kemi të qartë se nuk është një fshat Godanci por janë dy fshatra të ndara Godanci i Epërm dhe Godanci i Poshtem, dhe ato trajtohen ndaras sikurse fshatërat tjera të komunës sonë, dhe shumat e investimeve nuk mund të shihen si shuma të përbashkëta, por si investime të secilit fshat veq e veq. Sa i përket rrugës në fshatin Pjetërshticë ajo do të kryhet sivjet. Buxheti ka qenë i koduar, prandaj ç'do projekt që ka kod nuk mund të largohet. Mendoj se duhet të kemi një

rishikim të Buxhetit për këtë vit. Përgjigjet për Mollopolc i dha Bujar Ferati, kështu që ato janë projeksione për vitin 2024-2025.

z.Reshat Mujota; Po del në kundërshtim me Bujar Feratin, unë fola për vitin 2023 ku janë planifikuar 20 mijë euro, ka projekte këtë cilat mundemi me i hjekë, psh. 3 vatura i dalin boll Komunës, me pas mirëmenaxhim. A mund ta kryeni rrugën me trotuar dhe ndriqim me 20 mijë euro.

z.Lumni Amrushi; Ne nuk mundemi me thënë që ç'do sen që keni bërë ju keq e ne me thënë, mirë. Punimet eshtë dashuir me fillu në Pjetërshtic, për këtë unë kam bërë pyetje edhe më heret. Ndiçimi te rruga "Isak Brahimë" eshtë dashtë me u kry, le të kryhet qashtu qyshë eshtë. Pastaj kemi edhe lagjën te Musojt etj.

Kryetari, z.Qemajl Aliu; Insistova dy herë për të dhënë shpjegime, për çështje parimore, për me e liru debatin, sepse u kriju njëfar tamponi për me blloku sa më shumë debatin, me spekulime për 400 mijë euro, tash po del se fjala eshtë për rrith 50 mijë euro.

znj.Adelina Beqaj; Llogariti për tri vite e jo vetëm për një vit, e unë kërkoj falje vetem për fjalët e mia.

z.Bujar Ferati, zyrtar kryesor financiar; Konkretisht nga nesër e deri në Shtator, kanë me u harmonizuar projektet, dhe kemi me i diskutuar bashkërisht.

z.Hamëz Tërshani; Lidhje me Godancin u fol, Besnik mendoj se nuk eshtë në rregull me fillu me thënien, erdhi dita sepse Godanci asnjëherë nuk ka qenë i përjashtuar. Në Carralevë asnjëherë nuk ka pas investime më shumë. Qëllimi i KAB-it eshtë përmirësimi i jetës së qytetarit, kështu që edhe kundërshtimet tonë e kanë efektin e vetë. Ky version i KAB-it pasqyron mungesën e vizionit. Kryetari nuk ka pas njohuri bazike për qeverisjen lokale. Kryetar ke dhënë premtimë megalomane.

z.Besnik Seferi; Faleminderit që po ma mundëson replikën me ty edhe pse sot jam keq me shëndet, unë nuk jam kundër projekteve, i dhash arsyetimet konkrete. E din ti fort mirë për kritikat kur ke qenë drejtor. Unë ballafaqohem me ekzekutivin për interesat e qytetarëve. Për sa i përket veturave eshtë interes i Komunës që mos me i paguar rregullisht 8 mijë euro, por ti paguajmë ato me qëllim që në fund të na mbeten pronë e Komunës. Unë jamë në LVV-ë por nuk e ngoj askend, përveq dëshirën e qytetarit.

z.Përparim Ramusa; Ngritura e zërit nuk të bën më bindës. Ti Besnik ke kërkuar ndryshime, dhe tash qile guri gojën. Ti Kryetar e manipulon qytetarin, 80 mijë euro për vitin 2023, edhe ti Kryetar tash kërkoj falje Adelinës sepse nuk ka shpisur. Ne në këtë formë nuk e votojmë KAB-in.

z.Hamëz Tërshani; Nuk ma ke bërë vlerësimin mirë sepse unë nga drejtori jamë bërë asambleist. Ndërsa ti Besnik sa ke qenë në Kuvend gjithëherë ke folë vetëm për rrugën "Qamëria" gjithë kohën vetëm për këtë rrugë ke folë, prandaj edhe mundem lirshëm me thënë se je lokalist.

znj.Adelina Beqaj; E di Kryetar që ma ke frikën politikisht.

z.Bujar Ferati, zyrtar kryesor financiar; Fshatrat krejt janë të përfshira, në KAB, ndërekohë që deri në miratimin e buxhetit kanë me u ndryshuar shumë shifra. Nuk eshtë e mundur që me pas projekte 400 mijë euro, kjo nuk eshtë e vërtetë, shuma nuk e kalon 50 mijë euro.

Kryetari, z.Qemajl Aliu; Unë po flas që ta bëj të qartë për qytetarin sepse u përmenden këtu lloj, lloj shifra, kjo eshtë mungesa e kurajos. Eshtë pra evidentë përpjekja e juaj për ta manipuluar qytetarin, por nuk ka mundësi sepse buxheti i ritet edhe për 1.1 milion euro më shumë se sa ishte. Ky dokument i rëndësishëm i KAB-it i paraprinë Buxhetit të vitit 2023. Për herën e parë kanë me pa qytetarët e Komunës së Shtimes se nuk bëhet Buxhet për vota. Buxhetin do ta bëjmë duke i dëgjuar nevojat e qytetarëve si dhe duke respektuar prioritetet. Buxheti i kaluar eshtë bërë duke shkuar në fshatin Zborc dhe duke u thënë banorëve të fshatit se kemi me filluar sallën e sportit, me 5 mijë euro të ndara në Buxhet. Pastaj se kemi me i bërë edhe nënkalimet, ju ato nuk i keni bërë për 20 vjet, e tanë ne nuk kemi se si të ngutemi për me i bërë ato për 6 muaj. Sot qytetarët do ti kenë 3.6 milion investime në komunitetin tonë. Unë besoj se të gjithë do ti gjithë këtyre investimeve. Ju bëj thirrje që të gjithë unanimisht ta votoni KAB-in.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Ju vlerësoj për diskutimet e juaja. Mund të ketë në këtë dokument edhe gabime, mirëpo siç e dini këto janë vetëm projeksione për vitet 2023-2025.

z.Reshat Mujota: Kërkoj falje, për diskutimin, por e kemi edhe KPF-në, qka i ka rekomanduar KPF-ja Kuvendit, për aprosim. Qishtu me qito shifra unë nuk e votoj KAB -in. Unë kërkova që të rriten investimet te Shtabi në Rancë nga 5000€ në 10.000 ose 15.000€ dmth. investo ku e meriton, dmth. Rancë për vitin 2023 shuma 15.000€ që të realizohet.

z.Përparim Ramusa; Hala nuk je ngi me premtim populiste, normal që ki rritje të buxhetit kur ki rritje të çmimeve.

Kryetari, z.Qemajl Aliu; Prap po dua që ta sqaroj për hirë të qytetarëve, për sa i përket Shtabit të UÇK-së në fshatin Rancë, në muajin Shtator do ta rregullojmë rrugën deri te Shtabi, sa i përket këtyre 5.000€ ato janë aty fare kot, sepse nuk mund të kryhet punë me to. Ne e kemi diskutuar këtë çështje me z.Zogaj, nga Agjensioni për mbrojtjen e memorialeve, dhe jemi dakorduar për me filluar me hartu projektin për Shtabin e UÇK-së në fshatin Rancë. Dhe tek pasi ta dimë sakt vlerën e projektit do të fillojmë për ndarjen e mjeteve financiare me bashkëfinancim me Agjencionin e Memorialeve. Sikurse edhe me 10.000€ nuk ka sallë të sportit, kte duhet me ditë secili. Sallat sportive kemi me ua ndërtuar të gjitha shkollave në komunën e Shtimes. Ne jemi të përgjegjshëm në punën tonë, dhe do ti grumbullojmë dhe do ti ndajmë fondet e mjaftueshme për ndërtimin e sallave për ti ndarë sipas prioriteteve, siç është fshati Reçak i cili ka më shumë banorë se sa fshati psh. Zborc.

z.Përparim Ramusa; Mos gënje se nuk janë 10.000 euro por janë 40.000€ edhe për vitet tjera.

z.Hamëz Tërshani; 4.5 milion është mesatarja e investimeve të qeverisjes së kaluar.

z.Rrahman Jakupi; Te Ranca, unë e njoh problematikën aty, atje ka pas një problem pronësor. I falënderoj familjarët e pronës, nëse familja ka pranuar për atë pronë, e përgëzoj. Projekti për Rancë ekziston, unë jam i vetmi që kam pas fotografi.

z.Reshat Mujota; Sa e di unë qatherë kur kemi marrë vendim për Pjetërshticë ka qenë edhe për Rancë. 5.000€ janë për me bëré një rrugë, pse atëherë jo edhe 5.000€ për Shtabin.

z.Grejtalb Emini, drejtor i DPUKGJ; Shtabi i Pjetërshticës ka kushtuar 130.000€ ndërsa për Shtabin e Rancës janë ndarë 5.000€. Ruga nga Shtabi deri në Rancë i ka 450 metra. Kush ju ka ndaluar për me e ndërtuar këtë rrugë që 20 vjet. E këtu po përmendet një projekt ideorë me disa fotografi, që aspak nuk i përngjajnë Shtabit të UÇK-së në Rancë. Çështjet si ajo e sallës me 10.000€ e asaj me 5.000€ të parapara për Shtabin duhet të rregullohen me rishikimin e buxhetit.

z.Rrahman Jakupi; Mos u muno me e hudhë fajin, se aty ka pas probleme pronësore. Unë për secilën pjesë të punës jamë shumë krenarë.

z.Rexhep Gashi; U bënë shumë diskutime, disa u egzagjeruan. Konkret ishim aq sa ditëm. Un ë nuk i pashë projektet që i kam propozuar. Nuk ishte mirë nga ana e Kryesuesit që tha se nuk pashë asgjë konkrete, sepse ka më shumë se 10 projekte që i kanë propozuar asambleistët.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Po e sqaroj se projekti i rrugës Pjetërshticë – Zborc ishte gabim sepse është dashur të jetë Godanc i Epërm-Zborc, dhe kjo është përmiorësuar. Ndërsa për projektin e rrugës për Mollopolc e spjegoi Kryetari.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Konstattoi, Kuorumin prej 20 anëtarëve të Kuvendit prezent në mbledhje.

* **Kuvendi i Komunës, me 11 vota “Për” me 9 vota “Kundër” dhe me 0 vota “Abstenim”** miratoi Kornizën Afatmesme Buxhetore të Komunës së Shtimes për periudhën 2023-20245, duke marrë përbazë propozimet, që të rritet shuma e investimeve te projekti Nr.8 si dhe përmirësimi i gabimit teknik te projekti Nr.42.

Pika 4

Propozim -Vendim për zgjedhjen e dy anëtarëve të Komisionin për ndarjen e Bursave për Studentë
Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Para se të hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Lulzim Sahiti, drejtor i DKA; Përshëndetje, Propozim -Vendimin për zgjedhjen e dy anëtarëve të Komisionin për ndarjen e Bursave për Studentë, e keni pranuar me kohë dhe keni pas kohë të mjaftueshme për ta lexuar, kështu që unë nuk kam pse e lexoj, por vetem ju ftoj që ti zgjedhni dy përfaqësuesit nga Kuvendi që kërkohet me rregullore. Pasi ti zgjedhë Kuvendi, edhe ne do ti propozojmë anëtarët që kërkohet nga Ekzekutivi.

z.Besnik Seferi; Vitin e kaluar kanë qenë 24 bursa të ndara për studentë, na gjëzon fakti që këtë vit jan shumëfishuar dhe janë bërë 50 bursa që ndahen nga Komuna. Mendoj se një shpallje e tillë pëtr bursa është bërë pak e ngutshime, dhe mendoj se është bërë një shkelje e rregullores, dhe për këtë arsyе unë desha ta marr një sqarim nga drejtori.

z.Lulzim Sahiti, drejtor i DKA; Rregullorja ka ardhur dy herë në Kuvend, dhe ju jeni ata tgë cilët është dashur të bëni ndryshimet. Unë mendoj se në të ardhmen jo të largët rregullorja duhet komplet të ndryshohet. Deri tani kanë aplikuar 22 studentë.

znj.Besartë Musliu-Spahija; Përshëndetje, nga subjekti politik i PDK-së e propozojmë Albana Podvorica.

z.Reshat Mujota; Ndryshim të rregullores kemi ba. Ish drejtoresha ka bërë një njoftim, për të cilin është akuzuar, me qat ndryshim u pat bërë konkursi. Unë jam që të votohet në pako.

znj.Adelina Beqaj; Pasi që kemi rrjetje të bursave, e pashë që fakulteti i Infermerisë nuk ishte përfshi, propozoj që kjo pikë të shtyhet.

z.Rexhep Gashi; Nëqoftëse flitet për një ndryshim të rregullores, ne kemi pas një mbledhje ku për këtë konkurs është dashur me e ngritë shqetësimin tonë. Ne si opozitë e dhamë propozimin tonë.

z.Përparim Ramusa; Këtë pikë e kemi diskutuar edhe në KPF- KPF-ë dhe nëse rregullorja nuk është marrë për bazë atëherë shpallja duhet me u shty.

z.Lulzim Sahiti, drejtor i DKA; Me qat rregullore janë ndarë bursat vitin e kaluar.

z.Lumni Amrushi; Mujan me vazhdu me propozime, unë propozoj që Kuvendi të merret me këtë qëshqje, le ta rishikojnë në qoftëse e kanë bërë gabim, nëse është ashtu qysh tha Besniku.

znj.Slikurte Mustafa; Në emër të Subjektit politik, Lëvizja Vetvendosje ne e propozojmë Asllan Beqaj për anëtarë të Komisionit për ndarjen e bursave për studentë.

z.Besnik Seferi; Si anëtarë i komisionit që kam qenë mendoj se më e mira është që propozimet të shkojnë. Le të identifikohen nenet që duhet të ndryshohen dhe mos të përsëriten gjërat e njejtë.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Komitetet që i kemi formuar tani janë të rregullta, dhe tani kanë mundësinë që ta rishikojnë rregulloren.

z.Reshat Mujota; Edhe unë pajtohem që të propozohen emrat nga pozita dhe opozita, le të atëherë këta se do të zbatojnë rregulloren. Kuvendi le ta voton në pako.

znj.Adelina Beqaj; Paraprakisht unë propozova për me u shty, mirëpo pasi po propozohen emrat atëherë përgjegjësinë le ta merr drejtori i arsimit.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Konstatoi, Kuorumin prej 20 anëtarëve të Kuvendit prezent në mbledhje.

* **Kuvendi i Komunës, unanimisht miratoi, Vendimin për zgjedhjen e 2 (dy) anëtarëve të Komisionit nga Kuvendi, për ndarjen e Bursave për Studentë, për vitin akademik 2021/2022, nga gjithsejtë 5 (pesë) anëtarë sa është paraparë të zgjidhen sipas rregullores, si vijon:**

Dy anëtarë të Komisionit nga Kuvendi sipas nenit 13.1 pika (a) e Rregullores Komunale për ndarjen e bursave për Student, Nr.01/06/570-60 dt. 30.03.2012.

1. z.Besnik Shala (Përfaqësues nga pozita)

2. znj.Albana Podvorica.....(Përfaqësuese nga opozita)

Dy anëtarë të Komisionit nga Ekzekutivi, sipas nenit 13.1 pika (b) e Rregullores Komunale për ndarjen e bursave për Student, me numër 01Nr.06/570-60 dt. 30.03.2012, i ka emëruar Kryetari i Komunës, me vendimin Nr.02/ 291 të datës 04.07.2022 si vijon:

3. z.Besnik Seferi (Zyrtar për Arsim)

4. znj.Albulenë Emini.....(Inspektore për Ambient)

Një anëtar të Komisionit nga OJQ-të, sipas nenit 13.1 pika (c) e Rregullores Komunale për ndarjen e bursave për Student, 01Nr.06/570-60 dt. 30.03.2012, e dërgojnë përfaqësuesit e Studentëve ose shoqërisë civile: 5. z.Durim Ademaj.....(Përfaqësues i Studentëve).

Pika 5

Propozim – vendim për miratimin e Komisionit për përzgjedhjen e drejtorëve të shkollave

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Para se të hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Lulzim Sahiti, drejtor i DKA; Propozim – vendimin për përzgjedhjen e drejtorëve të shkollave e keni marrë me kohë, atë e kemi propozuar në Kuvend duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ për përzgjedhjen e drejtorave të shkollave. Ju ftoj që ta miratoni propozimin e DKA-së.

z.Përpasrim Ramusa; Te propozimi për zgjedhjen e drejtorëve, siq e dini Kryetari Aliu ka premtuar që arsimin dhe shëndetësinë ka me i depolitizuar. E ka vendosur drejtor të arsimit Lulzim Sahitin nga PDK-ja. Politizimi i dytë është se Lulzim Sahiti i ka bërë ushtrues të detyrës së drejtorit të shkollës dy persona që janë mjaft të politizuar.

z.Lulzim Sahiti, drejtor i DKA; Po dua të sqaroj edhe për ju por edhe për të gjithë të tjerët, se unë si i pavarur politikisht më ka emruar, Kryetari Aliu, drejtor të arsimit në komunën e Shtimes.

z.Rahman Jakupi; Për disa njerëz që nuk kanë fëtyrë nuk e pranojnë. Ti je kanë anëtarë i shtabit zgjedhor të PDK-së, dhe ke shku në Zborc dhe ke kërkuar vota. Ti je kthy me Vetvendosjen por në zemër e ke PDK-në. Ti ke probleme me ndërgjegjën, qytetarët heret a vonë kanë me e kuptu.

z.Lulzim Sahiti, drejtor i DKA; Tema e diskutimit në këtë pikë është miratimi i vendimit për zgjedhjen e Komisionit për përzgjedhjen e drejtorëve të shkollave në komunën e Shtimes, ju kisha lutë që ta miratoni këtë vendim, sepse unë nuk dua që këtu të humbim kohë me debate të kota politike, kjo le të mbetet në ndërgjegjen tënde, sepse unë nuk do të merrem me ty fare. E akuzon pa kurrfar baze zyrtarët e Kuvendit për gabime gjuhësore.

Kryetari, z.Qemajl Aliu; Po unë po përgjigj, në pyetjet që u ngritën, Sektori i shëndestësisë ashtu edhe qyhs kam premtuar, siç e dini tani është në duar të profesionistit të shëndetësisë, me gradë shumë të lartë shkencore akademike Dr.Sci.Isa Haxhiu, njeri i nderuar në komunën e Shtimes, përkundër juve që në krye të shëndetësisë e keni emëruar një Infermier. Ky është standardi im në përzgjedhjen e kuadrit të komunës. Sa po shoh e ke humbë pusullën ti Rahman, sepse me i nënqmuar njerzit më të devotshem të administratës komunale, me punën dhe përvojen më të gjatë, siç janë Idajet Rexhepi, Lulzim Sahiti, e Lulzim Muharremi, është e pa shembullt. Sa i përket kuadrit në arsim, të gjithë e dinë se njerzit që gjithë karrierën më përkushtim ja kanë kushtuar arsimit janë zoterit, Rexhep Hasani, Skender Bajrami, e Lutfi Gashi, të cilët janë emëruar vetëm Ushtrues Detyre të drejtorit të shkollës.

z.Përparim Ramusa; Kryetarë, je Kryetarë i Komunës së Shtimes, e merresh me asambleistë. E ke problem depolitizimin e arsimit. Me Lulin kemi qenë bashkë në Zborc, dhe kemi kërkuar vota.

Kryetari, z.Qemajl Aliu; Nëse kam folë fjalë ofenduese, le të më gjykojnë publiku, është e kuptueshme që për ty jam Kryetarë i keq, mirëpo po u them një gjë, se atëherë kur bëhem i nje vijë me jū unë nuk do të jemë në politikë.

z.Adelina Beqaj; Debatet politike përsë po i ngritë në Komunë, kur dëshironi depolitizimin e arsimit.

z.Hamëz Tërshani; Unë mendoj se keni mungesë të kuadrova, dhe për këtë arsyе i keni vendosë të PDK-së. Qeverisja e juaj qe 7 muaj nuk po mundeni me e pranuar një pozitë të Nënkyrytarit.

z.Lumni Amrushi; Po lidhem me Kryetarin, drejtorat e PDK-së, mu pas numru mishti nuk na kish mqu.

z.Rexhep Gashi; Juve të PDK-së unë ju përgëzoj që e paskeni një drejtor të arsimit nga PDK-ja në qeverisjen komunale, kjo është mirë.

z.Reshat Mujota; Me e ulë debatin në këtë nivel mua hiq nuk po më pëlqen, zgjedhja e drejtorave mua nuk më pengoh, pse nuk më pengon, sepse Kryetari vetë e ka zgjedhë drejtorin me të cilin donë me qeverisë komunën. Mirëpo unë jam këndër mënyrës se si është bërë Lulzim Sahiti, drejtor edhe ai i Kaqanikut, për të cilin unë nuk kam asgjë personale.

z.Muhamet Ademaj; Po vijën akuza në drejtum timin, por unë nuk do të merrem me ta.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Konstatoi, Kuorumin prej 20 anëtarëve të Kuvendit prezent në mbledhje.

* Kuvendi i Komunës, me 10 vota "Për" me 10 vota "Kundër" dhe me 0 vota "Abstenim" (Bazuar në nenin 48.1 të LVL-së Nr.03/L-040, ku thot "Në të gjitha takimet e kuvendit të komunës dhe komitetet e tij, çdo person, përfshirë edhe Kryesuesin, ka nga një votë, por

Kryesuesi ka një votë shtesë nëse votimi është i barabartë për ose kundër një propozimi” Në këtë rast Kryesuesi ka votuar “Për” Kështu që rezultati i votimit është si vijon me 11 vota “Për” me 10 vota “Kundër” dhe me 0 vota “Abstenim”), Kuvendi i Komunës e miratoi Vendimin për formimin e Komisionit për vlerësimin e kandidatëve që kanë konkurruar sipas kritereve të Konkursit në postin e Drejtorit, përkatësisht Zëvendës-Drejtorit, në Institucionet edukativ-arsimore të komunës së Shtimes, për të gjitha konkurret që do të shpalen gjatë vitit shkollorë 2021/2022, me mandat një vjeçar deri më 30.06.2023 si vijon:

1. z.Fatmir Zymeri – Zyrtar i Arsimit, përfaqësues nga Drejtoria Komunale e Arsimit,
2. znj.Adelajda Baftiu – Profesor/Asistent në Fakultetin Filologjik të Univerzitetit “Hasan Prishtina” në Prishtinë, e përfaqësuar në Komision si ekspert i pavarrur nga fusha e Arsimit.

Pika 6

Propozim-Vendim për caktimin e lokacionit për Cerdhe në fshatin Petrovë

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Para se të hapi diskutimin për këtë pikë, lexoi rekomandimin e KPF-së. z.Muhamed Ademaj; Ndërtimi i Çerdhes në fshatin Petrovë, është në interes të banorëve të fshatit, prandaj e përkrahim dhe do ta votojmë. E falënderoj kolegut nga ky fshat Asllan Beqaj që ka bashkëpunuar me banorët e fshatrit Petrovë. I tërheqi fjalët që i kalmë thë në mbledhjen e kaluar për bashkëfshatarin Gani Ademaj.

z.Asllan Beqaj; Përshtendetje, ne për Cerdhe e kemi organizuar një debat të gjerë publik, ku kemi diskutuar mjaft gjatë, kështu që debati nuk ka qenë keq as herën e parë e as herën e dytë, kanë dhënë mendimet e tyre por nuk ka pas asnjë që ka qenë kundër. Për këtë arsyen unë i ftoj gjithë kolegët që ta votojmë këtë projekt, që ka shumë rëndësi përfshatin tonë.

znj.Adelina Beqaj; Te ky projekt unë dyshoj shumë, edhe pse unë e përkrahu, ju garantoni që aty nuk del asnjë asht në atë lokacion. Ju duhet të jepni garancion.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Sa i përket këtijë lokacioni ku e ka propozuar drejtoria në qendër të fshatit Petrovë në pjesën e veqantë prej 7 ari, unë jamë konsultuar me njerëzit më të vjetër që i njoh të fshatit por edhe nga kusherit e mi dhe ata të gjithë më kanë thënë se aty te ajo pjesë nuk ka varreza, ky pra është garancioni që mund ta jap. Ju mund ti lexoni dhe ti shihni emrat dhe nënshkrimet e pjesmarrësve të fshatit në debatin publik, mendoj se nënshkrimet që i kanë dhënë ata është një garancion, aty ka pasë njerëz nga të gjitha subjektet politike. Unë ju ftoj që ta votojmë këtë projekt, sepse është në të kirën e të gjithë banorëve të fshatit Petrovë.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Konstattoi, Kuorumin prej 20 anëtarëve të Kuvendit prezent në mbledhje. Kuvendi i Komunës, me 12 vota “Për”, me 0 vota “Kundër” dhe me 8 vota “Abstenim” miratoi, Vendimin për ndarjen e truallit (oborr) për ndërtimin e (Çerdhes) Kopshtit për Fëmijë në fshatin Petrovë, me sipërfaqe prej: 00.07.00 (7 ari), në pjesën e ngastrës kadastrale me numër: P-72809066-01012-1, Zona Kadastrale - Petrovë, Evidentuar Pronë e Komunës së Shtimes.

Pika 7

Formimi i Komisionit për Vizita në Teren lidhur me Monitorimin e Implementimit të Investimeve Kapitale (mund të bëhet në bashkëpunim me shoqërinë civile)

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Përparim Ramusa; Unë po kërkoj nga drejtori i Urbanizmit të na jep sqarime.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Unë e propozoj që ta kemi një Komision prej 5 anëtarëve.

z.Rrashman Jakupi; Nëse ke mundësi që me na dhënë një bazë ligjore, sepse nuk po e dëmë funksionin e Komisionit,

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Sa i përket bazës ligjore unë mund të them se kjo pikë ka qenë e paraparë në Planin e Punës të cilin e ka aprovuar ky Kuvend, kaq mund të them për këtë.

z.Përparim Ramusa; Meqenëse e kemi Komitetin për Shërbime Publike, unë propozoj që të gjithë anëtarët e Komitetit të jenë pjesë e Komisionit në teren.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Konstatoi, Kuorumin prej 20 anëtarëve të Kuvendit prezent në mbledhje.
* **Kuvendi i Komunës,** unanimisht ka vendosur që komplet të gjithë anëtarët e Komitetit për Ambient, Shërbime Publike dhe Urbanizëm të zgjidhen si Komision për vizita në teren lidhur me monitorimin e implementimit të Investimeve Kapitale në komunën e Shtimes për vitin 2022, si vijon: **Adem Ramadani, Rrahman Jakupi, Muhamet Ademaj, Fetah Dugolli dhe Nexhat Neziraj.**

Pika 8


Informatë nga drejtoria për Inovacion

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Muhamet Ademaj; E njoftoj Kuvendin se shumë shpejt vajza ime nuk do të jetë, drejtoreshë e drejtorisë së Inovacionit.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Pasi që diskutime tjera nuk kishte, Kryesuesi mbledhjen e përfundoi në ora 15:37h.

Procesmbajtësi:
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i Kuvendit

Adnan Ademi

